

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Matura Shtetërore 2020

Lënda: Ekonomi

Tiranë 2020

1. Radhët e gjata në pritje për të blerë tipin e fundit të aparatit celular, tregojnë që në treg ka:

1 pikë

- A) tepricë oferte.
- B) ekuilibër tregu.
- C) **tepricë kërkesë.**
- D) mungesë kërkesë.

2. Zhvendosja majtas e lakores së ofertës, në kushtet kur faktorët e tjerë mbeten të pandryshuar, do të çojë në:

1 pikë

- A) nivel më të ulët se çmimi i ekuilibrit të mëparshëm.
- B) **sasi më të vogël se sasia e ekuilibrit të mëparshëm.**
- C) sasi më të madhe se sasia e ekuilibrit të mëparshëm.
- D) nuk do të ketë ndryshim as në çmim as në sasinë e ekuilibrit.

3. Kërkesa për një produkt bëhet më pak elastike kur produkti:

1 pikë

- A) është mall luksi.
- B) **është i domosdoshëm.**
- C) ka shumë zëvendësues.
- D) zë një përqindje të lartë në buxhetin e konsumatorit.

4. Nëse çmimi i një malli do të rritet, lakorja e kërkesës për mallin tjetër të lidhur me të do të zhvendoset djathtas. Këto dy të mira quhen:

1 pikë

- A) të mira normale.
- B) të mira inferiore.
- C) të mira plotësuese.
- D) **të mira zëvendësuese.**

5. Andi dëshiron të blejë një kompjuter të ri, por shoku i tij i thotë se do të ketë ulje të konsiderueshme çmimesh për kompjuterët. Cili është faktori që mund të ndikojë kërkesën për kompjuter në këtë rast?

1 pikë

- A) Shijet dhe preferencat e konsumatorit.
- B) Çmimi i faktorëve të prodhimit të mallit.
- C) **Pritjet dhe parashikimet për çmimin e mallit.**
- D) Çmimet e mallrave të tjerë të lidhura me mallin e dhënë.

6. Çmimi i mallit A në treg u rrit 15 %, sasia e blerë e këtij malli u ul 30%. Në këtë rast themi që për mallin A ka:

1 pikë

- A) ofertë elastike.
- B) ofertë joelastike.
- C) **kërkesë elastike.**
- D) kërkesë joelastike.

7. Cili nga faktorët e mëposhtëm do të rriste ofertën për grurë në treg?

1 pikë

- A) Rritja e çmimit të punimit të tokës.
- B) Kushtet e papërshtatshme të motit.
- C) **Qeveria u jep subvencione fermerëve.**
- D) Qeveria rrit taksat mbi produktet bujqësore.

8. Produkti marginal fizik tregon:

1 pikë

- A) tërësinë e faktorëve të prodhimit në periudhën afatshkurtër.
- B) nga produkti i përgjithshëm fizik sa i takon të ketë prodhuar një punëtor.
- C) sasinë maksimale të produktit që ka prodhuar firma duke përdorur faktorët e prodhimit.
- D) **shtesën në produktin e përgjithshëm kur ndryshon me një njësi faktori i ndryshueshëm.**

9. Cila nga alternativat e mëposhtme tregon koston për njësi të produktit?

1 pikë

- A) Kostoja fikse.
- B) Kostoja marginale.
- C) Kostoja e ndryshueshme.
- D) **Kostoja mesatare e përgjithshme.**

10. Nëse firma duhet të mësojë se sa i kushton prodhimi i një njësie shtesë produkti, ajo duhet të logarisë: **1 pikë**

- A) koston margjinale.
- B) koston mesatare fikse.
- C) koston mesatare totale.
- D) koston mesatare variabël.

11. Firma vepron në periudhë afatshkurtër prodhimi kur: **1 pikë**

- A) njëri nga faktorët e prodhimit është i fiksuar.
- B) vepron ligji i të ardhurave margjinale rritëse.
- C) periudha e prodhimit është më shumë se një vit.
- D) të gjithë faktorët e prodhimit janë të ndryshueshëm.

12. Mënyra se si një shoqëri ndërvepron për të prodhuar dhe shpërndarë të mirat dhe shërbimet quhet: **1 pikë**

- A) sistem ekonomik.
- B) tregues ekonomik.
- C) funksion prodhimi.
- D) mirëqenie ekonomike.

13. Rritja e kërkesës për biçikleta në treg do të shkaktojë: **1 pikë**

- A) uljen e ofertës për biçikleta në treg.
- B) uljen e të ardhurave nga shitja e biçikletave.
- C) uljen e kërkesës për punëtorë që prodhojnë biçikleta.
- D) rritjen e kërkesës për punëtorë që prodhojnë biçikleta.

14. Arbri vendos që burimet financiare që zotëron t'i shtojë duke i investuar në një biznes. Cili është parimi i ekonomizimit që nxit Arbrin për këtë investim? **1 pikë**

- A) Arritja e KMP.
- B) Maksimizimi i fitimit.
- C) Maksimizimi i mirëqenies.
- D) Maksimizimi i kënaqësisë.

15. Nëse në një zonë të caktuar kemi një numër të madh biznesesh fast-food që konkurrojnë me njëri – tjetrin, kjo do të bëjë që produktet e tyre të kenë: **1 pikë**

- A) çmim më të ulët dhe cilësi më të ulët.
- B) çmim më të ulët dhe cilësi më të lartë.
- C) çmim më të lartë dhe cilësi më të ulët.
- D) çmim më të lartë dhe cilësi më të lartë.

16. Tabela e mëposhtme na jep një firmë që vepron në konkurrencë të plotë si në tregun e produkteve dhe në tregun e punës. Çmimi i produktit është 10 njësi paraqe, ndërsa paga e një punëtori është 20.

L	0	1	2	3
TPP	0	10	15	18

Sa janë të ardhurat margjinale nga produkti punë kur firma punëson punëtorin e dytë? **1 pikë**

- A) 10
- B) 30
- C) 50
- D) 70

17. Cikli i prodhimit të një libri është më i gjatë se ai i prodhimit të një reviste. Oferta e librit krahasuar me revistën, paraqitet: **1 pikë**

- A) elastike.
- B) joelastike.
- C) plotësisht elastike.
- D) plotësisht joelastike.

18. Një individ merr 5,2% të fitimit të një shoqërie aksionere. Cili është kriteri mbi të cilin bazohet kjo e drejtë e tij? **1 pikë**

- A) Kësti i radhës në %.
- B) Norma vjetore në %.
- C) Aksionet që zotëron në %.
- D) Interesat e grumbulluara në %.

19. Kur firma nuk prodhon asnjë njësi produkti, shpenzimet e përgjithshme të saj janë të barabarta me shpenzimet: **1 pikë**

- A) për faktorët e fiksuar.
- B) mesatare totale të firmës.
- C) për faktorët e ndryshueshëm.
- D) për njësinë e fundit të prodhuar.

20. Nëse çmimi i karburantit në treg ulet, kërkesa për makina në treg do të rritet. Karburanti dhe makina në këtë rast janë: **1 pikë**

- A) të mira normale.
- B) të mira inferiore.
- C) të mira plotësuese.
- D) të mira zëvendësuese.

21. Glaudi blen çdo ditë një litër qumësht. Çmimi i qumështit u rrit, por Glaudi nuk e ndryshoi sasinë e qumështit dhe blen përsëri një litër. Në këtë rast, kërkesa e tij për qumësht është: **1 pikë**

- A) elastike.
- B) joelastike.
- C) me elasticitet njësi.
- D) plotësisht joelastike.

22. Në periudhën afatgjatë rezultojnë që: **1 pikë**

- A) shpenzimet për punën janë fikse.
- B) të gjitha shpenzimet janë të fiksuara.
- C) shpenzimet për kapitalin janë të fiksuara.
- D) të gjitha shpenzimet janë të ndryshueshme.

23. Kur çmimi i një produkti u rrit nga 50 në 100 lekë, sasia e ofruar për të nuk ndryshoi, ajo mbeti 80 kg. Oferta për këtë produkt është: **1 pikë**

- A) elastike.
- B) joelastike.
- C) plotësisht elastike.
- D) plotësisht joelastike.


24. Tabela e mëposhtme na tregon sasinë e produktit të prodhuar, çmimin dhe koston e firmës në periudhë afatshkurtër.

Q	0	1	2	3	4	5	6
P	40	35	30	25	20	15	10
TC	30	40	60	75	115	155	215

Sasia optimale që duhet të prodhojë kjo firmë është: **1 pikë**

- A) 3 njësi produkti.
- B) 4 njësi produkti.
- C) 5 njësi produkti.
- D) 6 njësi produkti.

25. Nëse firma në konkurrencë të plotë në periudhë afatshkurtër ka treguesit e pasqyruar si në grafikun e mëposhtëm, atëherë ajo rezultojnë me: **1 pikë**



- A) fitim normal.
- B) fitim oportun.
- C) fitim kontabël.
- D) fitim ekonomik.

26. Kostoja oportune përfaqëson: **1 pikë**

- A) vlerën e mallit të blerë.
- B) vlerën e mallit të shitur.
- C) vlerën e punës për prodhimin e mallit.
- D) vlerën e alternativës më të mirë të sakrifikuar.

27. Tabela e mëposhtme na tregon të dhënat mbi çmimin, sasinë e kërkuar dhe sasinë e ofruar në tregun e biçikletave.

Kombinimet	Çmimi	Sasia e kërkuar	Sasia e ofruar
A	10 000	90	10
B	20 000	80	30
C	30 000	50	50
D	40 000	30	80

Në këtë rast kemi: **1 pikë**

- A) $P_E = 10\ 000$.
- B) $P_E = 20\ 000$.
- C) $P_E = 30\ 000$.
- D) $P_E = 40\ 000$.

28. Sasia optimale që i siguron fitim maksimal firmës në periudhë afatshkurtër, përcaktohet nga kushti: **1 pikë**

- A) $MR=MC$
- B) $MR=MPP$
- C) $MR=AFC$
- D) $MR=ATC$

29. Në sistemin e sipërmarrjes së lirë, të gjithë agjentët ekonomikë kanë motiv kryesor: **1 pikë**

- A) shitje sa më të shumta.
- B) blerje sa më të shumta.
- C) shpenzime sa më të ulëta.
- D) përfitimin më të madh të mundshëm.

30. Lakorja e kërkesës së firmës individuale në konkurrencë të plotë është lakorja e: **1 pikë**

- A) kostos totale.
- B) të ardhurave totale.
- C) të ardhurave variabël.
- D) të ardhurave margjinale.

31. Tabela e mëposhtme na tregon të dhëna mbi çmimin, sasinë e kërkuara dhe të ofruara në treg për një produkt. Blerësit besojnë se çmimi i mallit do të rritet në të ardhmen, prandaj sasia e kërkuar ndryshon me 50 kg për çdo nivel çmimi. Nëse faktorët e tjerë do të mbeten të pandryshuar, atëherë: **1 pikë**

Kombini mi	Çmimi	Sasia e kërkuar	Sasia e ofruar
A	100	0	150
B	80	20	120
C	60	40	90
D	40	60	60
E	20	80	30

- A) Çmimi i ri ekuilibër do të jetë 60 dhe sasia e re ekuilibër 60.
- B) Çmimi i ri ekuilibër do të jetë 60 dhe sasia e re ekuilibër 90.
- C) Çmimi i ri ekuilibër do të jetë 60 dhe sasia e re ekuilibër 120.
- D) Çmimi i ri ekuilibër do të jetë 60 dhe sasia e re ekuilibër 150.

32. Lakorja e ofertës së tokës bujqësore në periudhë afatshkurtër është: **1 pikë**

- A) elastike.
- B) joelastike.
- C) plotësisht elastike.
- D) plotësisht joelastike.

33. Problemet, për të cilat tregu nuk jep zgjidhje efçente, quhen: **1 pikë**

- A) eksternalitete.
- B) të mira publike.
- C) të mira private.
- D) dështime të tregut.

34. Qeveria, me një ligj të veçantë, përcakton pagën minimale për punonjësit. Ky çmim i përcaktuar nga qeveria është: **1 pikë**

- A) çmim tregu.
- B) çmim tavan.
- C) çmim monopol.
- D) çmim dysheme.

35. Firmat mund ta diferencojnë produktin e tyre nëpërmjet: **1 pikë**

- A) krijimit të imazhit.
- B) hyrjes së lirë në treg.
- C) pranimin të çmimit të tregut.
- D) normës së lartë të përqendrimit në treg.

36. Nëse në një vit diplomohen një numër shumë i madh juristësh, kjo do të shkaktojë: **1 pikë**

- A) ulje të kërkesës për juristë dhe ulje të pagës së tyre.
- B) rritje të ofertës së juristëve dhe rritje të pagës së tyre.
- C) ulje të kërkesës për juristë dhe rritje të pagës së tyre.
- D) rritje të ofertës së juristëve dhe ulje të pagës së tyre.

37. Cilët nga agjentët e mëposhtëm ekonomikë janë subjekt i taksave speciale? **1 pikë**

- A) Korporatat.
- B) Firmat e vogla.
- C) Firmat me ortakë.
- D) Firmat individuale.

38. Mbajtësi i obligacioneve të një korporate ka të drejtën të marrë: **1 pikë**

- A) dividend nga firma.
- B) pjesë në drejtimin e korporatës.
- C) normë vjetore në përqindje rritëse.
- D) normë vjetore në përqindje të përcaktuar.

39. Nëse firmat mund ta shesin mallin vetëm me çmimin që përcakton tregu, pra të pranojnë çmimin e tregut, atëherë ato janë pjesë e strukturës: **1 pikë**

- A) oligopol.
- B) monopol.
- C) konkurrencë e plotë.
- D) konkurrencë monopolistike.

40. Struktura e tregut me një firmë të vetme në treg, quhet: **1 pikë**

- A) oligopol.
- B) monopol.
- C) konkurrencë e plotë.
- D) konkurrencë monopolistike.

41. Firma "ALB sh.p.k." shtoi kapacitetet magazinuese për produktin e gështenjave. Ky veprim i saj do të ndikojë në: **1 pikë**

- A) rritjen e ofertës së gështenjave.
- B) rritjen e kërkesës së gështenjave.
- C) elasticitetin e ofertës së gështenjave.
- D) elasticitetin e kërkesës së gështenjave.

42. Kostoja oportune është: **1 pikë**

- A) kostoja e blerjes së çdo lloji të mire.
- B) kostoja e njësisë së parë të prodhuar.
- C) kostoja e një njësie shtesë të prodhuar në një linjë prodhimi.
- D) kostoja e mallit nga i cili hiqni dorë për të blerë një mall tjetër.

43. Firma, e cila vepron në një treg me shumë shitës që diferencojnë produktin, i përket strukturës së tregut: **1 pikë**

- A) oligopol.
- B) monopol.
- C) konkurrencë e plotë.
- D) konkurrencë monopolistike.

44. Çmimi i mallit A rritet me 10% dhe kërkesa për mallin B të lidhur me të, rritet me më shumë se 10%. Në këtë rast mallrat A dhe B janë: **1 pikë**

- A) të mira normale.
- B) të mira inferiore.
- C) të mira plotësuese.
- D) të mira zëvendësuese.

45. Nëse rritet çmimi i siguracionit të makinave:
1 pikë

- A) sasia e kërkuar e makinave do të rritet.
- B) lakorja e kërkesës për makina zhvendoset majtas.**
- C) lakorja e kërkesës për makina zhvendoset djathtas.
- D) sasia e kërkuar për sigurimin e makinave do të rritet.

46. Për një të mirë, rritja 5% në çmim sjell uljen me 15 % në sasi. Në këtë rast: **1 pikë**

- A) oferta është elastike.
- B) kërkesa është elastike.**
- C) oferta është joelastike.
- D) kërkesa është joelastike.

47. Kostoja fikse e një firme është 10 000 euro. Firma prodhon 1000 njësi produkti dhe në këtë nivel prodhimi ka kosto mesatare të ndryshueshme 20 euro. Sa është kostoja e përgjithshme mesatare për këtë sasi prodhimi?

- A) 20
- B) 30**
- C) 40
- D) 50

48. Ligji i të ardhurave marginale rënëse përshkruan:
1 pikë

- A) lidhjen e kostos së përgjithshme me të ardhurat e përgjithshme.
- B) lidhjen e sasisë optimale me të ardhurat e përgjithshme të firmës.
- C) lidhjen mes sasisë optimale dhe shpenzimeve të përgjithshme të firmës.
- D) lidhjen midis faktorëve të prodhimit dhe produktit të prodhuar në periudhë afatshkurtër.**

49. Tregu në të cilin mund të blihen dhe shiten letra me vlerë, quhet: **1 pikë**

- A) bursë.**
- B) tregu i parasë.
- C) tregu i huasë.
- D) tregu i punës.

50. Era kohët e fundit ka krijuar biznesin e saj në formën e firmës individuale. Cila nga alternativat e mëposhtme përbën përparësi për firmën e saj?
1 pikë

- A) Jetëgjatësia e firmës.
- B) Fitimi i pashpërndarë.**
- C) Përgjegjësia e pakufizuar.
- D) Mundësia për financimin e firmës.

51. Cilin nga treguesit e mëposhtëm mund të llogarisim me ndihmën e bilancit të firmës?
1 pikë

- A) Vlerën neto.**
- B) Fitimin kontabël.
- C) Fitimin ekonomik.
- D) Të ardhurat e përgjithshme.

ë

52. Qeveria, ndërhyr në ekonominë e tregut për shkak se tregu:
1 pikë

- A) rrit konkurrencën.
- B) zbut konkurrencën.
- C) njeh dështime dhe papërsosmëri.**
- D) i përdor burimet në mënyrë efçente.

53. Zbatimi i parimit të ekonomizimit për konsumatorin nënkupton:
1 pikë

- A) arritjen e fitimit maksimal.
- B) plotësim të të gjitha nevojave.
- C) plotësim të të gjitha dëshirave.
- D) zgjedhje optimale në kushtet e pamjaftueshmërisë.**

54. Forma e biznesit që kërkon një statut, ku përcaktohen rregullat e funksionimit të tij, është një: **1 pikë**

- A) korporatë.
- B) biznes i vogël.
- C) firmë me ortakë.
- D) firmë individuale.

55. Cila nga shtyllat e sipërmarrjes së lirë nxit përdorimin e burimeve në mënyrë sa më efiçente? **1 pikë**

- A) Çmimi.
- B) Prona private.
- C) Aftësia sipërmarrëse.
- D) Konkurrenca midis blerësve.

56. Ela ka dëshirë që të marrë një kredi konsumatore për blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake. Cila nga alternativat e mëposhtme përbën një disavantazh për Elën? **1 pikë**

- A) Normat e ulëta të interesit.
- B) Procedurat për marrjen e kredisë.
- C) Kthimi i kredisë nëpërmjet pagesave me këste.
- D) Nxitja për të shpenzuar më shumë se mundësitë.

57. Konkurrenca e bizneseve për punë më të kualifikuar çon në: **1 pikë**

- A) uljen e çmimit të faktorit punë.
- B) rritjen e çmimit të faktorit punë.
- C) uljen e numrit të të punësuarve.
- D) rritjen e numrit të të punësuarve.

58. Nëse norma e interesit do të rritej nga 5% në 8% kjo do të bënte që: **1 pikë**

- A) firmat të blinin më pak kapital.
- B) firmat do të eksportnin më shumë.
- C) firmat do të blinin më shumë kapital.
- D) firmat nuk do të ndikoheshin fare nga kjo rritje.

59. Konceptimi të mira normale-të mira inferiore, lidhet me: **1 pikë**

- A) çmimin.
- B) të ardhurat.
- C) preferencat.
- D) parashikimet.

60. Familja e Albës përbëhet nga tre persona, Alba dhe prindërit e saj. Të ardhurat mujore janë gjithsej 120 000 lekë. Ata kanë vendosur të planifikojnë shpenzimet e tyre duke krijuar një buxhet. Shpenzimet e domosdoshme janë planifikuar 82 000 lekë ndërsa shpenzimet jo të domosdoshme 14 000 lekë. Vlera e kursimit të familjes së Albës do të jetë: **1 pikë**

- A) 0 lekë.
- B) 24 000 lekë.
- C) 38 000 lekë.
- D) 106 000 lekë.